



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:205970

Datë: 13.11.2024

Numri i dokumentit: 06445266

PKR.nr.385/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Gazmend Bahtiri, me bashkëpunëtoren profesionale Albana Curri, në cilësi të procesmbajtëses, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.H., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, e evidentuar nën shenjën PP/I.nr.44/23, të datës 18 dhjetor 2023, e pranuar në gjykatë me datë 19 dhjetor 2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, me datë 12 nëntor 2024, në prezencën e Prokurorit të shtetit A.H., të akuzuarit B.H. dhe mbrojtësit së tij sipas autorizimit M.H. avokat në Podujevë, të njëjtën datë publikisht shpalli, ndërsa me datë 13 nëntor 2024, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.H. nga i ati S. dhe ëma F. (e lindur R.) i lindur me datë ..., në fshatin G..., Komuna P..., tani me vendqëndrim në Gj..., me numër personal të ID-së ..., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, me profesion - frizer, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar - Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datën 09 nëntor 2022 rreth intervalit kohor 13:35-13:40 në rrugën “....” në P..., i pandehuri B.H., pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ashtu që kur njësitë policore e kanë ndalë, gjatë kontrollimit në trupin e tij, të pandehurit B.H. i janë gjetur gjashtë (6) paketime me bari, ngjyrë e gjelbër, substancë narkotike e llojit Marihuanë me peshë të përgjithshme 6.94 ± 0.0001 gram.

Me këto veprime ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 72 lidhur me nenin 267 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe neneve 276, 361, 364, 365, 367, 368, 369, 449 dhe 452, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshme KPPRK) të akuzuarin e:

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1,000.00 (një mijë) euro, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 500,00 (pesëqind) euro, të cila dënime i njëjti detyrohet t'i paguajë në afatin prej tridhjetë (30) ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund t'a paguaj gjobën e lartcekur, gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë në dënim me burgim, duke e llogaritur 20,00 (njëzet) euro, e barabartë me një (1) ditë burgim.

URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike Marihuanë me peshë të përgjithshme 6.94 ± 0.0001 gram, ashtu që DETYROHET Policia e Kosovës - Njësitë DHTN - DKKO në Prishtinë, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, që pas verifikimit të sendeve të lartcekura, të bëjë asgjësimin e tyre, e këtë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50,00 (pesëdhjetë) euro dhe në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit shumën prej 50,00 (pesëdhjetë) euro, e gjitha këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të marr formën e prerë.

A r s y e t i m

Historiku procedural

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, në këtë gjykatë me datë 19 dhjetor 2023, ka parashtruar aktakuzën e evidentuar nën shenjën P/I.nr.44/23, të datës 18 dhjetor 2023, kundër të akuzuarit B.H., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së.

Shqyrtimi fillestar

Gjykata në kuadër të kompetencës territoriale dhe asaj lëndore, pas vlerësimit të të metave juridike dhe formale të aktakuzës, me datë 12 nëntor 2024, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale, në të cilin shqyrtim kanë prezantuar Prokurori i Shtetit A.H., i akuzuari B.H. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit M.H. avokat në Podujevë.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit dhe pasi që Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari, është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, i njëjti më parë i njoftuar lidhur me natyrën, pasojat dhe benefitet pranimit të fajësisë, ashtu që i është ofruar mundësia e deklaramentit të tij rreth fajësisë, të pranojë fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

Pranimi i fajësisë nga i akuzuari

I akuzuari B.H. në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar si vijon: e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, pendohem, premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, është hera e parë dhe e fundit që kam rënë ndesh me ligjin, unë tashmë jetoj në

Gj... kam rregulluar çështjen e dokumentacionit dhe jetën time. Në mënyrë vullnetare i jam përgjigjur kësaj gjykate dhe përsëri do të shkoj në Gj..... meqenëse atje jetoj. Kërkoj nga gjykata nëse është e mundshme një dënim sa më të butë.

Mendimi i palëve në raport me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar si vijon: pajtohem me këtë pranim fajësie pasi që është në pajtim me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga i njëjti. Andaj, i propozoj gjykatës që të njëjtin të e shpallë fajtor lidhur me veprën penale që i vihet në barrë, të e dënoj sipas ligjit dhe pranimin e fajësisë të e merr si rrethanë lehtësuese meqenëse tani i njëjti është person familjar, jeton në Gj..., po ashtu ka qenë i moshës së re kur e ka kryer veprën penale dhe është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.H. - M.H. avokat në Podujevë lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar si vijon: pasi që i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë, është i gjendjes së mesme ekonomike, është i moshës së re, për herë të parë ka ndodhur ky rast dhe më nuk do të ndodhë mbasi jeton dhe vepron në Gj..., i njëjti më nuk do të merret më me këso lloj veprime të tilla. Andaj, kërkoj nga gjykata që të njëjtit të i shqiptoj një dënim sipas ligjit sa më të butë.

Aprovimi i pranimin të fajësisë nga gjykata

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari, vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtjen e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmbanë aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtëses së të akuzuarit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës ka vlerësuar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së, duke e aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari në shqyrtimin fillestar, andaj konform nenit 242 paragrafi 6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Elementet e veprës penale

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, si dhe nga deklarami i të akuzuarit, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të te njëjtit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së, me të cilën është paraparë se: “*Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet*”.

Andaj, me veprimet konkrete të te akuzuarit i cili ditën kritike pa autorizim kishte poseduar substancë narkotike të llojit Marihuanë me peshë të përgjithshme 6.94 ± 0.0001 gram, përkatësisht gjashtë (6) paketime, me qëllim shitjes dhe shpërndarjes, e të cilin fakt e ka pranuar në tërësi i njëjti dhe atë që në stadin e parë të procedurës penale, përkatësisht në polici në rastin konkret konsumohen elementet e veprës penale e cila i është vënë në barrë nga organi i akuzës.

Vendimi mbi sanksionin penal

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 me të cilën dispozitë janë përcaktuar rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, si dhe nenin 70 me të cilën dispozitë janë përcaktuar rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit

Rrethanat lehtësuese

Gjykata si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjeti faktin se i njëjti në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i është vënë në barrë, ashtu që fakti se i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe ka shprehur pendesë, tregon se ndjehet përgjegjës për veprimet e tij, çka tregon nivel të ndërgjegjësimit të të kuptuarit dhe reflektimit mbi sjelljet e tij, marrë faktin se i njëjti ka filluar një jetë të re jashtë vendit, përkatësisht në shtetin e Gj.... Po ashtu si rrethanë lehtësuese për të njëjtin gjykata ka marrë edhe faktin se i akuzuari për herë të parë ka

rënë ndesh me ligjin, e që një gjë të tillë e ka vërtetuar në Sistemin e Evidencës Penale të kësaj gjykate, nga rezulton se i njëjti ka një të kaluar të pastër kriminale.

Rrethanat rënduese

Gjykata si rrethana rënduese për të akuzuarin ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale të të njëjtit të kryer me dashje direkte dhe paramendim, si dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, që është shëndeti i të rinjve.

Andaj, me aplikimin e nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPPK-së, ku është përcaktuar se: *“Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 i këtij Kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim: nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej dy (2) vjet, dënimi mund të zbutet deri në gjashtë (6) muaj burgim”* e ka bërë zbutjen e dënimit nën minimumin e paraparë ligjor, ashtu që të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale si dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zëvendësimi i dënimit me burgim me dënim me gjobë

Gjykata lidhur me zëvendësimin e dënimit me burgim, në dënim me gjobë është marrë bazuar në nenin 44 paragrafi 1 të KPRK-së, ku është përcaktuar se: *“Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar. Sa i përket dënimit me gjobë në këtë rast për të akuzuarin gjykata, përveç rrethanave të cekura ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar të të akuzuarit është i përballueshëm për kushtet ekonomike dhe të ardhurat që realizon i njëjti.*

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim, është marrë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, me të cilën dispozitë është paraparë se: *“Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siç parashihet në paragrafin 3. të këtij neni. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet”.*

Vendimi mbi konfiskimin

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve, përkatësisht substancës narkotike të llojit marihuanë me peshë të përgjithshme 6.94 ± 0.0001 gram, është marrë konform nenit 267 paragrafi 5 të KPRK-së, ku është përcaktuar se: *“Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen”*, si dhe nenit 276 paragrafi 2, pika 2.2 të KPPRK-së e cila dispozitë ka përcaktuar pasurinë që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Krimeve të Rënda

PKR.nr.385/23, me 13 nëntor 2024

B. Profesionale,
Albana Curri

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari,
Gazmend Bahtiri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për gjykatën dhe palët.